

VEPRA TË KOMPOZUARA NË PIKTURË NË VITET '70



Arti pamor

Fjalë kyçe: arritje artistike, kompozime artistike, kompozime historike, kompozime të zhnrit, jeta sociale, historia e popullit shqiptar, etj.

ARDIAN ISUFI

Abstract

Veprimtaria e gjerë dhe arritjet e shquara ideoartistike të arteve figurative në mesin e viteve '70 e më tej janë një evolucion i mëtejshëm në shkallë më të lartë i arritjeve dhe trajtave dalluese që ato kishin formuar më parë. Një veprimtari e tillë u bë në kushtet kur vazhdonte me ritme të shpejta ndërtimi socialist i vendit. Baza ekonomike e socializmit u zhvillua dhe u forcua më tej, u arritën suksese të rëndësishme në ekonomi. Gjatë këtyre viteve u ngritën dhe u vënë në shfrytëzim shumë objekte, u rrit prodhimi industrial dhe bujqësia arriti plotësimin e plotë të nevojave të vendit me drithëra. Këto suksese sollën një rritje të dukshme të nivelit të jetesës së masave të popullit të fshatit dhe të qytetit dhe rritën shumë nevojat e kërkesat e tyre për arsim e kulturë. Rrjeti i institucioneve artistike e kulturore u zgjeruar në masë të konsiderueshme. Një veprimtari e gjerë letrare, artistike kulturore në përmbajtje socialiste revolucionare e kombëtare dhe me nivel zhvillohet deri në skajet më të largëta të vendit. Kjo rritje vihet re edhe te artet figurative.¹ Në Tiranë u ngrit godina e re e Galerisë së Arteve Figurative. Galeri arti u hapën edhe në qytete të tjera. Në disa rrethe u hapën degë të reja të arteve figurative në shkolla të mesme artistike, kurse Instituti i Lartë i Arteve u forcua si shkollë kombëtare realiste e revolucionare. Prej këtyre shkollave kanë dalë një numër i konsiderueshëm, piktorësh, skulptorësh dhe grafistësh, e në veçanti ata të arteve dekorative dhe të arteve të aplikuar. Të gjithë këta faktorë ndikuan si në rritjen e dukshme të krijimeve artistike figurative, ashtu edhe për shtrirjen e tyre dhe pasurimin me vepra të nivelit të lartë artistik e të stileve të ndryshme.²

Zhvillim më të madh dhe arritje më të shumta ideoartistike në vitet '70 pati kompozimi figural, ndonëse në disa drejtime nuk mbetën prapa peizazh dhe portreti. Kompozimet e përmasave të mëdha qenë të shumta, por edhe kur ishin të vogla, përgjithësisht ato trajtonin tema të rëndësishme shoqërore historike me frymëmarrje të gjerë e patos revolucionar. Ato pasqyronin ngjarje konkrete të lavdishme ose dukuri të përgjithshme nga historia e popullit shqiptar, nga e kaluara si dhe nga aktualiteti socialist, momente të shndërrimeve madhështore të jetës socialiste, nga veprimtaria revolucionare e masave me heronj, protagonistët e karaktere tipike të kohës. Shumë nga kompozimet e këtyre viteve, qofshin historike apo të zhanrit, ishin epike.

Përmbajtja e tyre ideoartistike domethënëse e me forcë emocionuese shprehte frymën e lartësuar patriotike luftarake, entuziazmin revolucionar të njeriut të kohës, të klasës punëtore e të të gjithë masës së popullit, vendosmërinë e tyre për realizmin e idealeve të shoqërisë socialiste e të Partisë. Shumë prej tyre janë ndihmëse shumë e çmuar në thesarin e artit të realizmit socialist.³

Duke rimarrë temën e vetëmohimit të heroit për lirinë dhe interesat jetike të popullit, piktori Sali Shiraku, arrin realizmin e saj më të plotë në tablonë Mic Sokoli (1976, GAT), ku i jep figurës artistike një kuptim të lartë simbolik.

¹ Historia e Artit Shqiptar, nr. 2, Instituti i Lartë i Arteve, Mihal Duri, Tiranë, 1988, f.180.

² Po aty, f.180-181.

³ Historia e Artit Shqiptar, nr. 2, vep. e cit., f.182.

Kuptimplotë për përmbajtjen e re që sjell piktura e realizimit socialist dhe e bukur për vlerat e saj është tabloja Zëri i masës ose Punëtorët në studion e piktorit (1974, GAT). Përfytyrimi edhe emocionet që bart ajo janë të reja dhe të pasura

Në një stil monumental, më vëllim në plane të sheshta e të mëdha e ngjyra të pastra intensive që ka përpunuar, Vilson Kilica krijon tablo masive që kapin momente historike nga koha jonë ose nga shekujt e kaluar. Tabloja Denoncimi i Traktatit të Varshavës (1974 GAT) e Vilson Kilicës që më saktë është mitingu për denoncimin e Traktatit të Varshavës.

“Gjyqi i kryengritësve në Sinjë” (1978 GAT) është një nga realizimet e tij më të bukura. Larmia e ngjyrave të pastra e të dukshme të kuqe, të bardha, jeshile, blu, të verdha, të zeza. Kështu, në një mënyrë realiste, tabloja tregon me madhështi epike për gjyqin e ushtarëve turq të kapur nga fshatarë të ngritur kundër reformave të Tanzimatit në fillim të shekullit XIX.

Kështu është edhe 29 Nëntor 1944 (1976, GAT) e Ismail Lulanit, e cila nuk përmban asnjë figurë konkrete të njohur. Ajo paraqet një grup partizanësh duke dalë në fotografi, mbi sfodin e një qyteti tipik shqiptar te veriut të mbuluar me dëborë në ditën e Çlirimit të gjithë Shqipërisë.

Ndonëse me përmasa të vogla në krahasim me shumë tablo të tjera historike Shote Glica (1974, GAT) e Ismail Lulanit ka madhështi të veçantë. Kësaj i shtohet edhe profili i zbehtë, i vuajtur, por krenar, i heroinës së pamposhtur

Ngjarjet e mëdha historike, vepra e heronjve popullorë të Shqipërisë së Veriut, veçanërisht të Kosovës dhe jeta e kësaj krahine përbëjnë temën e një radhe kompozimesh të Abdurrahim Buzës, i cili jep në këtë periudhë një prodhim të shumtë. Për krijimin e tyre piktori ka menduar qysh prej shumë vitesh.

Në mënyrë s atë vërtetë aq edhe origjinale e tregon historinë tabloja “Kuvendi i Lidhjes” (1978 GAT) e këtij piktori, së cilës shtrirja horizontale, ndarja simetrike, masa e njerëzve të ulur përqark, koloriti i ngrohtë i japin një gjendje të veçantë solemne, të gjalla e të përzemërt.

Por në tablonë e tij “Azem Galica me shokë çan rrethimin” (1976, GAT) ku figurat e luftëtarëve në një pozicion shumë të veçantë, krijojnë një si emblemë kuptimplotë. Karakteristikë e kësaj me kurriz, sy të mëdhenj, qeleshe të vogël e flokë të gjata, kështu të bashkuar ata përbëjnë një figurë të vetme që lëviz dinamike përpara. Ata përfaqësojnë trimërinë e guximin e shqiptarit.

Në tablonë “U themelua Partia” (1974, GAT) Shaban Hysa arrin një nga realizimet e tij më të bukura që është edhe një kompozim më të shquara historike të pikturës së realizimit socialist. Në të është pasqyruar çasti i madh historik kur në mbledhjen e grupeve komuniste, në të aguar të 8 Nëntorit 1941, u vendos themeli i Partisë Komuniste Shqiptare dhe kur pjesëmarrësit betohen. Ata qëndrojnë më këmbë, të tendosur e duke nderuar me grusht rreth një tryeze të vogël të mbuluar me një cohë të kuqe. Në mes të saj është një llambë e vogël vajguri.

Në një radhë tablosh historike të krijuara pas vitit 1973 dhe ku protagonisti kryesor është udhëheqësi i partisë dhe i popullit shoku Enver Hoxha, kërkohen zgjidhje e forma të pikturës monumentale. Disa herë arrihet në krijimin e kompozimeve artistikisht lartësuese të momentit historik, pro herë të tjera këto forma monumentale janë të jashtme dhe japin përfytyrime në frymë ceremoniale ose tablo me një funksion më fort ilustrues.

Me zgjidhje e forma të pikturës monumentale është konceptuar “Ndarja e tapive” (1973, Presidiumi i Kuvendit Popullor) e Guri Madhit, e cila pasqyron një moment nga zbatimi i Reformës agrare në vitet e para pas Çlirimit: Fshatarët myzeqarë duken sikur hedhin valle të madhe me udhëheqësin e popullit shqiptar, shokun Enver Hoxha në mes. Prapa tyre hapet fusha e Myzeqesë ende djerrë e me kasolle.

Kompozimi historik mund të quhet tabloja “Gju më gju me popullin” e Zef Shoshit që ka si subjekt një episod nga vizita e shokut Enver Hoxha në krahinën e Tropojës më 1970. Grumbullimi i malësorëve rreth udhëheqësit të Partisë e të popullit, duke biseduar para sfondit të bjeshkëve është pasqyruar me një dritë të qetë që i përmbledh vëllimet në një modelim të lëmuar.

Më 1978 Agim Zajmi ekspozoi tablonë “Ngritja e flamurit në Deçiq më 1911”, një nga pikturat më të realizuara të ekspozitës kombëtare të hapur me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Momenti kulmor historik është dhënë përmes një kompozimi dinamik.

Temën e luftës së popullit shqiptar për liri e pavarësi kombëtare piktori Arben Basha (L. 1947) e trajton në një tablo të karakterit të zhanrit. Kompozimi i tij “Drita e diturisë” (1978, GAT) tregon një orëmësimi në një nga shkollat e para shqipe të periudhës së Rilindjes Kombëtare, në kushtet e robërisë osmane.

Tabloja “Do të kini nënë Partinë” (1976, GAT) e Liliana Çefës trajton temën e humanizmit partizan, të dashurisë proletare për popullin e thjeshtë.

Pra duhet theksuar fakti se kompozimi figural i viteve '70 e pasqyron gjerë dhe me mendim artistik lartësues jetën e klasës punëtore, të fshatarësisë e të të gjitha masave punonjëse, jetën e tyre të përditshme në socializëm. Kompozimi figural viteve '70, duke dhënë edhe një prodhim të shumtë, zhvilloi më tej arritjet e deritanishme të pikturës shqiptare të realizimit socialist, pasqyroi realitetin aktual dhe të së kaluarës më gjerë e më thellë në anët e tij të reja edhe me një shprehje të re e të zhdërvjellët artistike. Në këtë mënyrë këto tablo transmetojnë me realizëm e forcë emocionale atmosferën, gjendjen shpirtërore, psikologjinë e vërtetë aktive revolucionare të shoqërisë socialiste të kohës me temperamentin e gjallë kombëtar dhe shpeshherë më një frymë optimiste.

Literatura

Historia e Artit Shqiptar, Nr. 1, Grup autorësh, Mihal Duri, Tiranë, 1990.
Historia e Artit Shqiptar, Nr. 2, Mihal Duri, Tiranë, 1988.